



Bazuar në dispozitat 38.3 dhe 38.4 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall:

KONKURS për Zëvendësguvernator

BQK është institucion i pavarur i themeluar me ligj të veçantë, ndërsa funksionet e saja kryesore janë: të sigurojë sistem financiar të qëndrueshëm; të rregullojë, licencojë dhe mbikëqyrë institucionet financiare; të mirëmbajë sistem të pagesave të sigurt dhe efikas; të kontribuojë në stabilitetin e çmimeve; të menaxhojë rezervat ndërkombëtare të vendit; të veprojë si bankier, agent fiskal dhe këshilltar financiar për Qeverinë dhe entitetet e tjera publike; të kryejë analiza ekonomike dhe prodhojë statistika monetare-financiare dhe të bilancit të pagesave.

Krahas plotësimit të kriterëve të përcaktuara me nenet 40 dhe 41 të Ligjit për BQK-në, të gjithë kandidatët duhet t'i njohin politikat dhe aktivitetet me rëndësi ndërlidhur me misionin, objektivat dhe kompetencat e BQK-së, të kenë përvojë të theksuar në vendimmarrje dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të proceseve, të posedojnë veçori personale që reflektojnë integritet dhe reputacion të lartë, si dhe të demonstrojnë aftësi të shkëlqyeshme ndërpersonale dhe komunikuese.

Zëvendësguvernatori ndihmon Guvernatorin në realizimin e detyrave të tij dhe të njëjtit i delegohen detyra specifike nga ana e Guvernatorit.

Të gjithë kandidatët duhet t'i parashtrojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është 13 gusht 2021.
- Aplikimi mund të bëhet përmes postës elektronike paneli@bqk-kos.org ose përmes Arkivit të BQK-së, rr. Garibaldi nr. 33.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes ueb-faqes: www.bqk-kos.org
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e panelit do të thirren në intervistë.